



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 291, datë 17.5.2023

PËR

**DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.1128, DATË 30.12.2020,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN  
NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE  
TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN,  
NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE  
NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr.72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.1128; datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 7, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/432 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/572, (CFSP) 2023/756 ...";
- b) Në pikën 8, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/408 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/847...";
- c) Në pikën 19, pas fjalëve "... (CFSP) 2023/381 ..." shtohen "... (CFSP) 2023/646, (CFSP) 2023/727, (CFSP) 2023/849 ...";
- ç) Pas pikës 30 shtohet pika 31, me këtë përmbajtje:

"31. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2014/450, "Për vendosjen e masave kufizuese në funksion të situatës në Sudan", të ndryshuar, sipas aneksit 31, bashkëlidhur këtij vendimi."



d) Pas pikës 31 shtohet pika 32, me këtë përmbajtje:

NR.PROT. 2107/1  
DATË 16.5.2023

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E  
JASHTME  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRISË SË BRENDSHME  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË  
MINISTRISË SË MBROJTJES  
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT  
RURAL  
BANKËS SË SHQIPËRISË  
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME  
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**



“32. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2023/726, “Për ndryshimin e disa vendimeve të Këshillit në lidhje me masat kufizuese për të vendosur dispozita për një përjashtim humanitar”, që ndryshon vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2010/413, (CFSP) 2010/788, (CFSP) 2014/450, (CFSP) 2015/740, (CFSP) 2015/1333, (CFSP) 2016/849, (CFSP) 2016/1693, (CFSP) 2017/1775, sipas aneksit 32, bashkëlidhur këtij vendimi.”

2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2023/572, (CFSP) 2023/756, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
  3. Në aneksin 8, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2023/847, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  4. Në aneksin 19, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2023/646, (CFSP) 2023/727, (CFSP) 2023/849, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
  5. Pas aneksit 30, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 31, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  6. Pas aneksit 31, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 32, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr.72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTRI PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME**

**OLTA XHAÇKA**